

Statistikat afatshkurtra

Prodhuësit e të mirave - Tremujori IV 2025

Tiranë, më 19 Mars 2026: Treguesit tremujorë mbi prodhuësit e të mirave, përfshijnë aktivitetet ekonomike: Industri (Industri Nxjerrëse dhe Industri Përpunuese); Energji elektrike, Gaz, Avull; Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve; Ndërtim, në tremujorin e katërt 2025, paraqiten si më poshtë:

Industria:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 2,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rënie 0,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 2,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rënie 1,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Energji elektrike, Gaz, Avull:


- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 10,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 5,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 2,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 16,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 7,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 4,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 2,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 0,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Ndërtimi:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 3,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 2,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 5,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 8,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum (%)**Tab. 1 Indeksi i shitjeve neto në volum, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2		Aktiviteti ekonomik	Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja		Tr.IV 2025 (2021=100)	IV.25 / IV.24 (%)	Tr.IV 2025 (2021=100)	IV.25 / III.25 (%)
B-C	05-33	Industri	84,7	-2,0	83,6	1,8
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	56,7	-8,7	55,5	2,0
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	92,0	-0,9	88,8	1,1
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	72,1	-10,0	62,8	-7,1
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	117,4	7,0	126,7	2,1
F	41-43	Ndërtim	165,1	3,1	132,2	1,0
Grupimet industriale kryesore						
		Mallra të ndërmjetme	77,6	-0,7	74,1	-0,5
		Energji	67,3	-12,6	59,5	-5,1
		Mallra kapitale	95,8	-10,0	86,7	1,5
		Mallra të qëndrueshme konsumi	101,7	4,3	88,0	1,3
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	107,4	3,5	105,6	-0,3

Tab. 2 Indeksi i prodhimit në volum, prodhuesit e të mirave

NVE Rev.2		Aktiviteti ekonomik	Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja		Tr.IV 2025 (2021=100)	IV.25 / IV.24 (%)	Tr.IV 2025 (2021=100)	IV.25 / III.25 (%)
B-C	05-33	Industri	88,4	-0,5	84,0	0,5
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	56,4	-10,0	55,5	1,6
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	99,7	1,4	95,5	0,4
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	113,4	5,9	83,2	13,6
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	127,2	4,5	127,7	-2,8
F	41-43	Ndërtim	167,5	2,6	132,6	1,1
Grupimet industriale kryesore						
		Mallra të ndërmjetme	87,7	7,4	83,0	2,6
		Energji	95,0	6,7	74,9	28,8
		Mallra kapitale	92,2	-13,4	84,2	-1,3
		Mallra të qëndrueshme konsumi	105,1	5,4	90,5	2,1
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	103,7	0,6	100,0	0,1

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Statistikat Afatshkurtra – Prodhuesit e të mirave](https://www.instat.gov.al/)

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <https://www.instat.gov.al/>

Metodologjia

Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

Në prodhuesit e të mirave:

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor, në anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
- Energji elektrike, gaz, avull (35)
- Furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve (36-39)
- Ndërtim (41, 42, 43)

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Për këtë tremujor janë përdorur burimet administrative dhe intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2021=100, Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash, Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres, Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatoen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më pare.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtë vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur, etj.

Përkufizimet e treguesve kryesorë

Shitjet neto - *Shitjet neto* përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

Indeksi i shitjeve neto - Objektivi i indeksit të *shitjeve neto* është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime.

Numri i të punësuarve me pagesë - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përjashtuar të vetëpunësuarit me pagesë).

Paga dhe trajtime - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimet (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese,

Indeksi i fondit të pagave - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

Grupimet Industriale Kryesore janë një rigrupim i aktiviteteve Industri Nxjerrëse, Industri Përpunuese dhe Energji të detajuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2), si më poshtë:

Grupimet Industriale Kryesore	NVE Rev.2
Mallra të ndërmjetme	• 07-09 Nxjerja e mineraleve natyrore; Nxjerja e mineraleve të tjera nga minierat; Aktivitete mbështetëse minerare • 13000 Përpunimi i tekstileve • 16000 Prodhimi i drurit dhe materialeve prej druri, përveç mobiljeve • 17000 Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre • 20-21 Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike; Përpunimi i produkteve farmaceutike • 22000 Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës • 23000 Prodhimi i produkteve minerale jo metalike • 24000 Metalurgjia • 255XX Farkëtimi, stampimi, petëzimi dhe trafilizimi i metaleve • 27000 Prodhimi i pajisjeve elektrike
Energji	• 05-06 Nxjerja e qymyrit dhe linjiteve; Nxjerja e naftës bruto dhe gazit natyror • 19000 Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës • 35000 Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri i kondicionuar
Mallra kapitale	• 251XX Prodhimi i produkteve metalike strukturore • 262XX Prodhimi i kompjuterave dhe pajisjeve periferike • 28000 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t • 33000 Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve
Mallra të qëndrueshme konsumi	• 264XX Prodhimi i produkteve elektronike për konsumatorët • 31000 Prodhimi i mobiljeve • 32XXX Industri të tjera p,k,t
Mallra të paqëndrueshme konsumi	• 10000 Përpunimi i produkteve ushqimore • 11-12 Prodhimi i pijeve; Prodhimi i produkteve të duhanit • 14000 Konfeksionimi i veshjeve • 15000 Prodhimi i lëkures dhe produkteve prej lëkure • 18000 Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara • 32YYY Industri të tjera p,k,t

Përshtatja sezonale

Përshtatja sezonale në seritë tremujore të prodhimit të të mirave materiale u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2.4. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspesifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2006 - Tremujori IV 2025. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative).